



Presidenti Bajram Begaj dekreton “gjeneralmajor” Arben Kingjin, SHSHHPFA

Presidenti i Republikës së Shqipërisë sh. t. z. Bajram Begaj, në mbështetje të nenit 92, shkronja “d”, e nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të pikës 3, shkronja “b”, të nenit 9 të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe

autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, me propozim të Kryeministrit, ka dekretuar mesditën e sotme dhënien e gradës madhore “gjeneralmajor”...



faqe 2

Ministri Peleshi nënshkruan Memorandumin e Mirëkuptimit në fushën e Mbrojtjes dhe të Sigurisë



faqe 3

ASNI, 92 vite shërbim ‘inteligjent’ i Forcave të Armatosura

Krijimi i Shërbimit apo Armës së Ndërlidhjes vite më parë përbën një moment të rëndësishëm në një nga shërbimet me rëndësi të veçantë në funksionimin, por në radhë të parë për komandimin e strukturave ushtarake të Forcave tona të Armatosura. Zanafilla e krijimit të kësaj agjencie daton, më 30 qershor 1931, me krijimin e dy kompanive të ndërlidhjes dhe një kompani telegrafiste. Pas gjithë këtyre viteve shërbim ndërlidhje, sot ASNI është në gjendje të sigurojë dhe të mbështesë me sisteme komunikimi...



Faqe 5

Shkolla e Trupës në procesin e arsimimit dhe trajnimit të personelit ushtarak në vite

QAPU, roli, kontributi dhe vizioni për trajnimin e personelit ushtarak në FA “Bijtë e Nënës Shqipëri bëhen bashkë në Bunavi!”, vargje drithëruese që dëgjohen fuqishëm nga garnizoni i Bunavisë, dhe më tej kënga vazhdon “Betohe për Flamur, stërviten dhe s’lodhen kurrë”, vargjet e kësaj kënge përfshinë gjithë dinamikën e këtij garnizoni. “Ne gjithmonë do t’u nderojmë ku do vemë... ku do shkojmë, si kujtimin e rinisë, shkolla e parë e ushtrisë...”, këngë apo betim ushtarak është premtimi më domethënës i rekruteve të cilët premtojnë të jenë të aftë të shërbejnë me dinjitet...



Faqe 6

Prigozhin, një mercenar i dehur

Mercenarët, siç i kam analizuar në një shkrim të fillim-marsit 2023, “Mercenarët, e ardhmja apo e shkuara e luftës”, janë ushtarë për para, ose “pata të egra” që shtegtojnë atje ku ka gjak, luftëra dhe konflikte në shkëmbim të parasë. Historia i njeh rastet kur “të punësuarit”, që janë mercenarët ngrihen dhe rebelohen, kundër punëdhënësve të tyre, ose nga pakënaqësia e trajtimit ose nga egoja dhe “dehja” që ata fitojnë gjatë betejave. Paraja dhe plaça e luftës jo gjithmonë i mjafton atyre dhe kështu ata synojnë pushtetin politik. Mercenarët janë vrasësit me pagesë...



Faqe 10

Presidenti Bajram Begaj dekreton “gjeneralmajor” Arben Kingjin, SHSHPFA

Presidenti i Republikës së Shqipërisë sh. t. z. Bajram Begaj, në mbështetje të nenit 92, shkronja “d”, e nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të pikës 3, shkronja “b”, të nenit 9 të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, me propozim të Kryeministrit, ka dekretuar mesditën e sotme dhënien e gradës madhore “gjeneralmajor” për shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjeneral brigade Arben Kingji.

Me këtë rast Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi uroi gjeneralmajor Kingjin: Një vlerësim i merituar për përkushtimin dhe kontributin e pakursyer.



Gjeneralmajor Arben Kingji, në ceremoninë e përcjelljes së ekipit të Policisë Ushtarake në misionin e Forcës Shumëkombëshe dhe Vëzhguese në Sinai, Egjipt

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Arben Kingji mori pjesë në ceremoninë e përcjelljes së ekipit të Policisë Ushtarake në misionin e Forcës Shumëkombëshe dhe Vëzhguese në Sinai, Egjipt.

Në ceremoni ishin të pranishëm gjithashtu edhe zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor Manushaqe Shehu, komandanti i Policisë Ushtarake, kolonel Shkëlqim Çela, drejtorë drejtorish në MM dhe SHP, etj.

Në përshëndetjen e tij në këtë ceremoni, gjeneralmajor Kingji u shpreh ndër të tjera se: “Angazhimet në misionet e ndryshme jashtë vendit aktualisht vazhdojnë të ngelen një nga detyrat tona më të rëndësishme. Me nisjen e këtij ekipi të Policisë Ushtarake në misionin e Forcës Shumëkombëshe dhe Vëzhguese në Sinai, Egjipt, Policia Ushtarake dhe Forcat tona të Armatosura zgjerojnë gjeografinë e angazhimeve dhe kontributeve tona në botë...”.

Më tej, gjatë përshëndetjes së tij SHSHPFA, gjeneralmajor Arben Kingji pasi vlerësoi faktin që FARSH merr pjesë për herë të parë në një mision me rëndësi kritike dhe në një angazhim të suksesshëm të SHBA-së për stabilitetin rajonal në Lindjen e Mesme që prej 40 vitesh, u shpreh besimplotë që ekipi i Policisë Ushtarake do të tregojë përgjegjshmëri dhe profesionalizëm, si në të gjitha misionet që FARSH-të janë angazhuar. “Në kushtet kur ky është edhe efektivi ynë i parë që angazhohet në këtë mision në një rajon vazhdimisht të nxehtë dhe delikat, sikurse është Lindja e Mesme, emri, profili dhe gjurmët që do të lini ju, do të jenë baza dhe avantazhet e grupeve pasardhëse që do të shërbejnë atje. Unë kam besim të plotë tek përgjegjshmëria, përkushtimi dhe ambicia juaj, se si gjithmonë dhe si të gjithë efektivet tanë të angazhuar kudo në misionet jashtë vendit, do ta kryeni këtë shërbim me faqe të bardhë, do të na nderoni dhe do të jeni shembull për ekipin e radhës...”, - u shpreh ndër të



tjera gjeneralmajor Arben Kingji.

Misioni i Sinait është një forcë civilo-ushtarake e përbërë nga tre (13) shtete nën lidhshmëri amerikane dhe është me rëndësi kritike dhe një angazhim i suksesshëm

i SHBA-së për stabilitetin rajonal në Lindjen e Mesme që prej 40 vitesh dhe mbikëqyr dhe siguron zbatimin e dispozitave të sigurisë të Traktatit të Paqes Egjiptiano-Izraelit të vitit 1979.



Përfundoi faza e parë e kursit për ekspertët shqiptarë të Mbrojtjes Civile

Në kuadër të projektit “Krijimi i Qendrës Operative Kombëtare për Emergjencat Civile të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile Shqiptare”, financuar nga Agjencia Italiane e Bashkëpunimit për Zhvillim, për një shumë prej 1.2 milionë eurosh, u zhvillua kursi për Operatorët Shqiptarë të Mbrojtjes Civile, në bashkëpunim dhe koordinim me Departamentin e Mbrojtjes Civile të Kryesisë së Këshillit të Ministrave të Italisë dhe me Mbrojtjen Civile të Toskanës/zyrtetit metropolitan të Firences.

Trajnimit të realizuar përmes pesë moduleve teorike, në të cilat morën pjesë 24 operatorë të Sallës Operative të Emergjencave Civile dhe stafi i Bashkisë së Tiranës, iu shtua dhe një ushtrim praktik që synonte përsosjen e reagimit të Mbrojtjes Civile Shqiptare pas ngjarjeve katastrofike, për menaxhimin e llojeve të ndryshme të emergjencave (përmbajtje, zjarre, tërmete, etj.). Pjesa e dytë e kursit do të zhvillohet në Itali, pranë Departamentit të Mbrojtjes Civile të Kryesisë Italiane të Këshillit të Ministrave dhe Mbrojtjes Civile të Toskanës/zyrtetit metropolitan të Firences.

Nisur nga shtimi i ngjarjeve katastrofike të viteve të fundit, programi përputhet plotësisht me një prioritet gjithnjë në rritje të qeverisë shqiptare, si në nivel qendror ashtu edhe në atë vendor: emergjencat civile.

Kurset synojnë të përfshijnë, në mënyrë të strukturuar, të qëndrueshme dhe proaktive, njohuritë italiane të Mbrojtjes Civile, si një model ekselence i njohur ndërkombëtarisht.

Ministri Peleshi nënshkruan Memorandumin e Mirëkuptimit në fushën e Mbrojtjes dhe të Sigurisë

Ministri i Mbrojtjes, zoti Niko Peleshi zhvilloi një vizitë zyrtare në Izrael. Z. Peleshi u prit me një ceremoni zyrtare në Ministrinë e Mbrojtjes të Izraelit nga homologu i tij, zoti Yoav Gallant.

Ministrat e Mbrojtjes nënshkruan Memorandumin e ri të Mirëkuptimit në fushën e Sigurisë dhe të Mbrojtjes, marrëveshje e nivelit të lartë që krijon një bazë solide ligjore për bashkëpunimin në fushën e sigurisë, mbrojtjes, teknologjisë ushtarake, trajnimeve dhe shkëmbimit të informacionit.

Zgjerimi dhe intensifikimi i bashkëpunimit, që është kornizuar në çdo dispozitë të marrëveshjes së re do të reflektojë marrëdhëniet e shkëlqyera historike dhe diplomatike si dhe vlerësimin reciprok që populli hebre dhe ai shqiptar kanë për njëri-tjetrin. Bëhet fjalë për një draft të negociuar prej disa muajsh nga stafet respektive me qëllimin dhe dëshirën e mirë për të nisur, një epokë të re bashkëpunimi në fushën e Mbrojtjes dhe të Sigurisë.

Dy ministrat biseduan në lidhje me zhvillimet më të reja në fushën e Mbrojtjes dhe të Sigurisë në Ballkanin Perëndimor, Lindjen e Mesme si dhe në Ukrainë.

Zoti Peleshi rikonfirmoi vullnetin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe të qeverisë shqiptare për intensifikimin e bashkëpunimit me Izraelin në fushën e Mbrojtjes në mënyrë të veçantë në sigurinë kibernetike, industrinë e mbrojtjes dhe shkëmbimin e informacionit.

Ministri i Mbrojtjes theksoi se qëndrimi i Shqipërisë për Lindjen e Mesme vijon të jetë ai për një rajon në paqe dhe në stabilitet, me një dialog të qëndrueshëm ndërmjet faktorëve, por theksoi se nuk ka asnjë tolerancë për aktet terroriste kundër shtetit të Izraelit dhe popullit të tij, pasi terrori dhe dhuna kundër një populli nuk mund të tolerohet dhe të justifikohet.

Vëmendje të veçantë gjatë diskutimeve mori situata në Ballkanin Perëndimor. Zoti Peleshi vlerësoi



Ministrat e Mbrojtjes nënshkruan Memorandumin e ri të Mirëkuptimit në fushën e Sigurisë dhe të Mbrojtjes, marrëveshje e nivelit të lartë që krijon një bazë solide ligjore për bashkëpunimin në fushën e sigurisë, mbrojtjes, teknologjisë ushtarake, trajnimeve dhe shkëmbimit të informacionit.

mbështetjen që Izraeli i jep Republikës së Kosovës, njohjen e pavarësisë së saj dhe ftoi Zotin Gallant për një lobim më të fuqishëm për shtimin e njohjeve ndër-

mjet vendeve që janë ende skeptike.

Vizita e ministrit të Mbrojtjes në Izrael vijoi me z. Yuli Edeistein, Kryetar i Komisionit Parlamentar për Politikën e Jashtme dhe Mbrojtjen, i cili rikonfirmoi vullnetin e plotë për të avancuar marrëdhëniet mes dy vendeve. Izraeli është një aleat dhe partner i rëndësishëm në mbrojtje dhe siguri si dhe një anëtar aktiv i Dialogut Mesdhetar të NATO-s.

Një pjesë e rëndësishme e takimeve të ministrit Peleshi ishte dhe ai me z. Gaby Portnoy (Big Gen ret.), Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë Kombëtare Kibernetike të Izraelit, i cili u shpreh se ishin të interesuar të intensifikonin bashkëpunimin për sigurinë kibernetike, përmes sistemit të të dhënave, ngritjen e kapaciteteve kombëtare si dhe në fushën e mbrojtjes.



Gjeneral brigade Ilir Xhebexhia pret Atashetë Ushtarakë Amerikanë



Komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia priti në një vizitë njohëse Atashetë Ushtarakë Amerikanë, nënkolonel David Millner dhe nënkolonel Eric Cote. Gjeneral Xhebexhia uroi nënkolonelin Eric



Cote për detyrën e re dhe theksoi që bashkëpunimi i shkëlqyer me SHBA-të do të vijojë dhe të thellohet edhe më shumë për të rritur kapacitetet operacionale dhe bashkëpunuese në të ardhmen.



Përfundoi me sukses stërvitja "KFOR-23" në Hohenfels, Gjermani.



Efektivët e batalionit të dytë të këmbësorisë vijojnë me sukses stërvitjen "Arcade Ledger" në Paderborn, Gjermani. Stërvitja zhvillohet në kuadër të "VJTF 24".



Komanda Mbështetëse vizitohet nga delegacioni i Qendrës Ndërkombëtare të Kërkim - Shpëtimit në Kosovë

Në kuadër të bashkëpunimit ushtarak ndërmjet Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe Forcave të Sigurisë së Republikës së Kosovës, një delegacion i Qendrës Ndërkombëtare të Kërkim - Shpëtimit, kryesuar nga drejtori i kësaj qendre, kolonel në rezervë John Doone, kreu një vizitë për shkëmbim eksperience në Komandën Mbështetëse dhe repartet e saj të varësisë.

Gjatë vizitës ata u pritën nga komandanti i Komandës Mbështetëse, gjeneral brigade Ferdinand Dimo.

Në këtë takim u diskutua për bashkëpunimin e deritanishëm midis dy institucioneve si dhe fushat e mundshme të bashkëpunimit për të ardhmen. Më pas, në drejtimin e shefit të Shtabit të KM-së, kolonel Arben Dhuli, delegacioni u prezantua me një briefing mbi misionin dhe detyrat e KM-së.

Delegacioni vijoi vizitën në Shkollën e Trupës së KM.

Në Bazën e Mbështetjes së Emergjencave Civile, delegacioni u njoh me detyrat që kryen ky repart në EC si dhe asistoi në një mësim tregues realizuar nga efektivat të ndarë në tre stacione, shuarjes së zjarreve në terren, kërkim nën rrënoja në rast tërmetesh dhe kërkim-shpëtim në terren malor.



Emërohet komandanti i Batalionit të Mbështetjes me Shërbime në Forcën Tokësore, nënkolonel Gazmir Kola. Ceremonia u zhvillua në ambientet e Forcës Tokësore me pjesëmarrjen e komandantit të FT-së, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, Shefit të Shtabit të FT-së, si dhe komandantëve të reparteve vartëse.



Në ambientet e repartit ushtarak 1030 Poshnjë, Berat, u zhvillua ceremonia e përcjelljes së kontingjentit të dytë të FARSH-së, në përbërje të Grup Batalionit të NATO-s në aktivitetin e vigjilencës së përfunduar eVa/eFP në Novo Sello, Bullgari.

Në ceremoninë e organizuar me këtë rast, morën pjesë shefi i Shtabit të Forcës Tokësore, kolonel Beqir Tafili, komandanti i batalionit, kolonel Gëzim Marku, si dhe familjarë të efektivave të kontingjentit paqeruajtës.



Komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra priti në një takim atashetë ushtarakë të SHBA-së

Komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra zhvilloi një takim me atashen ushtarak të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, kapiten i rangut I David Millner, në kuadër të përfundimit të mandatit të atashut ushtarak rezident në Tiranë. Kundëradmiral Agastra i uroi mirëseardhjen dhe vlerësoi bashkëpunimin e shkëlqyer ushtarak dypalësh midis vendeve në fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes. Gjatë takimit u prezantua atashu i ri ushtarak i SHBA-ve, kapiten i rangut I Eric Cote. Gjithashtu midis dy palëve u diskutua për bashkëpunimin në fushën e arsimimit dhe kontributin e SHBA-ve për arsimimin e personelit të Forcës Detare dhe për planet e modernizimit dhe situatën e Sigurisë Rajonale Detare. Kundëradmiral Agastra i uroi suksese atashut të ri të SHBA-ve dhe shprehu bindje për mbështetjen dhe vijimin e bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes.





ASNI, 92 vite shërbim 'inteligjent' i Forcave të Armatosura

Krijimi i Shërbimit apo Armës së Ndërlidhjes vite më parë përbën një moment të rëndësishëm në një nga shërbimet me rëndësi të veçantë në funksionimin, por në radhë të parë për komandimin e strukturave ushtarake të Forcave tona të Armatosura.

Zanafilla e krijimit të kësaj agjencie daton, më 30 qershor 1931, me krijimin e dy kompanive të ndërlidhjes dhe një kompani telegrafiste. Pas gjithë këtyre viteve shërbim ndërlidhje, sot ASNI është në gjendje të sigurojë dhe të mbështesë me sisteme komunikimi dhe informacioni për realizimin e komandim-kontrollit të FA-së në nivel strategjik dhe operacional në të gjitha kohërat si dhe të shkëmbejë informacion me NATO-n, të trajtojë dhe të stërvitë personelin e shërbimit të ndërlidhjes në FA.

Ky shërbim ndër vite ka pësuar ndryshime të njëpasnjëshme, duke pasur dhe vëmendjen e liderëve politik dhe ushtarakë të Forcave të Armatosura. Sot njihet ASNI, e cila planifikon, zhvillon, instalon dhe siguron pajisjet e sistemet kompjuterike dhe të komunikimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Ajo siguron përputhshmëri me sistemet e automatizuara të komandimit, kontrollit, komunikimeve dhe ato kompjuterike të NATO-s.

ASNI menaxhon dhe garanton sigurinë e sistemeve të automatizuara të informacionit të FARSH-së. Trajnon personelin e nevojshëm që kërkohet për të përdorur dhe mirëmbajtur sistemet e automatizuara dhe të ndërlidhjes të FARSH-së.

Kjo agjenci është një arterie dhe komponent shumë i rëndësishëm dhe i pa zëvendësueshëm i gjithë përpjekjes që FA-të bëjnë për të mbajtur me nder edhe me dinjitet pozicionin që u takon si pjesë e NATO-s.

Sot kjo strukturë numëron 92 vite aktivitet me sfida dhe arritje. Në Strategjinë e Sigurisë Kombëtare përcaktohet se: “Shqipëria renditet ndër vendet ku zhvillimi i telekomunikacionit, qasja në internet dhe informatizimi i shoqërisë përparon shumë shpejt. Rritja e komunikimit përbën një vlerë të shtuar në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit, por në të njëjtën kohë, ajo e ekspozon atë ndaj rreziqeve të natyrës kibernetike me aktorë shtetërorë dhe jo shtetërorë.

Sulmet kibernetike kanë potencial për të dëmtuar rëndë shkëmbimin e informacionit në institucionet publike, të telekomunikacionit dhe sistemin financiar e bankar, duke shkaktuar edhe ndërprerje të shërbimeve jetike. Asetet dixhitale në rritje janë pjesë integrale e operacioneve ushtarake, ndërkohë, rritja e varësisë së punës nga asetet dixhitale, krijon kërcënime të mjedisit të sigurisë kibernetike.

Me Siguri Kibernetike do të kuptojmë: kushtet në të cilat hapësira kibernetike është e mbrojtur në lidhje me ngjarjet aksidentale ose me vetëdëshje të cilat konsistojnë në marrjen dhe

transferimin e të dhënave, në modifikimin e tyre, shkatërrimin ose bllokimin e paligjshëm të sistemeve të komunikimit e të informacionit, për shkak të masave të papërshtatshme të sigurisë.

Fusha dixhitale e hapësirës kibernetike është fusha e pestë e operacioneve ushtarake në botë, së bashku me ajrin, detin, tokën dhe hapësirën.

Teknologjia e komunikimit dhe e informacionit i mundëson Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura (MM/FA) efikasitetin në Komandim - Kontroll, mbështetje logjistike dhe shërbime të tjera të cilat janë të mbështetura në sistemet e komunikimit dhe informacionit.

Kjo strategji e promovuar nga MM synon: mbajtjen e një mjedisi operimi elektronik të sigurtë, të qëndrueshëm dhe të besueshëm, i cili mbështet sigurinë në strukturat e MM/FA dhe rrit përfitimet e mjedisit dixhital për to; vendosjen e standardeve për përdorimin e sigurt të hapësirës kibernetike; inkurajimin për një zbatim gjithëpërfshirës; garantimin e sigurisë dhe progresit për strukturat dhe sistemet e ndërlidhjes dhe informacionit (SNI) të MM.

Strategjia e Sigurisë Kibernetike përshkruan sfidat aktuale në çështje të sigurisë të sistemeve të ndërlidhjes dhe informacionit (SNI) dhe pikat kryesore me qëllim për të përballuar këto sfida. Një sërë faktorësh si shpejtësia e zhvillimeve teknologjike, dinamika dhe kompleksiteti i shfrytëzimit të hapësirës kibernetike, e vendosin Ministrinë e Mbrojtjes dhe FA përpara sfidave reale për ngritjen e kapaciteteve për mbrojtjen kibernetike, të shoqëruar me politika, udhëzime, procedura koordinuese e monitoruese. Për rrjedhojë, Strategjia e Mbrojtjes Kibernetike do të rishikohet në përshtatje me këto ndryshime.

Qëllimi kryesor i saj është të sigurojë orientime, koherencë dhe fokus, për një qasje gjithëpërfshirëse, për të zhvilluar kapacitetet ushtarake në hapësirën kibernetike në tre vitet e ardhshme. Ministria e Mbrojtjes përcakton sigurinë kibernetike nëpërmjet masave në lidhje me konfidencialitetin, disponibilitetin

dhe integritetin e informacionit që trajtohet, përpunohet, ruhet, transmetohet dhe komunikohet me mjetet elektronike. Vendosija dhe zbatimi i këtij prioriteti për MM/FA, përcakton nevojën në: Menaxhimin e riskut të hapësirës kibernetike përmes përpjekjeve të vazhdueshme për rritjen e nivelit të trajnimit, sigurimin e informacionit, informimit më të konsoliduar për situatën dhe duke krijuar mjedis të sigurt dhe sisteme të qëndrueshme; Garantimin e integritetit dhe disponibilitetit të sistemeve nëpërmjet bashkëpunimit dhe mbrojtjes kolektive, duke mbajtur pamje operationale të përbashkët; Garantimin e kapaciteteve të integruara, duke bashkëpunuar ngushtë me Komandat e FA-së, Shërbimet dhe Agjencitë për vendosjen e kapaciteteve të reja atje ku ato nevojiten më shumë. Strukturat përkatëse të sistemeve të ndërlidhjes dhe informacionit (SNI) të MM/FA punojnë në mënyrë aktive për të siguruar infrastrukturë të sigurt për këto sisteme, nëpërmjet organizimit, alokimit të burimeve të duhura, kushteve të përgjithshme të mira dhe masa efektive.

Këto struktura integrojnë sigurinë dhe forcat në infrastrukturën e informacionit për të mbrojtur veprimtarinë e MM-së dhe FA-së si dhe të gjithë përdoruesit e këtyre sistemeve. Strategjia e Mbrojtjes Kibernetike do të ketë përputhshmëri me kërkesat që shtrohen vazhdimisht në këtë fushë dhe do të respektojë të gjitha parimet e parashikuara në konventat, marrëveshjet ndërkombëtare, iniciativat që do të ndërmerren, me synimin që të mbrojë dhe parandalojë ndërhyrjen ose dëmet në Sistemet e Ndërlidhjes dhe Informacionit (SNI).

Kjo Strategji do të fokusohet në: • Masa për të adresuar kërcënimet që drejtohen ndaj sistemeve të ndërlidhjes dhe informacionit (SNI) të MM dhe FA. • Masa ndërgjegjësuere për krimin kibernetik. • Masa për të ndërtuar besimin dhe sigurinë në përdorimin e sistemeve të ndërlidhjes dhe informacionit (SNI) të MM dhe FA. • Zhvillimi, rishikimi dhe rifreskimi i politikave, rregullave, udhëzimeve dhe procedurave ekzistuese për të siguruar përputhshmëri me kërkesat aktuale.

Shkolla e Trupës në procesin e arsimimit dhe trajnimit të personelit ushtarak në vite



INTERVISTOI: ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

QAPU, roli, kontributi dhe vizioni për trajnimin e personelit ushtarak në FA

“Bijtë e Nënës Shqipëri bëhen bashkë në Bunavi!”, vargje drithëruese që dëgjojen fuqishëm nga garnizoni i Bunavisë, dhe më tej kënga vazhdon “Betohe për Flamur, stërviten dhe s’lodhen kurrë”, vargjet e kësaj kënge përfshinë gjithë dinamikën e këtij garnizoni.

“Ne gjithmonë do t’u nderojmë ku do vemë... ku do shkojmë, si kujtimin e rinisë, shkolla e parë e ushtrisë...”, këngë apo betim ushtarak është premtimi më domethënës i rekruteve të cilët premtojnë të jenë të aftë të shërbejnë me dinjitet brenda dhe jashtë Shqipërisë.

Me këtë premtim domethënës mbyllet cikli stërvitor në Qendrën e Arsimimit Profesional të Ushtarëve në Bunavi, aktivitetin e së cilës komandanti i saj nënkolonel Bujar Fejzo për lexuesin e shtypit ushtarak do e sjellë si më poshtë.

Nënkolonel Bujar Fejzo, është diplomuar në Akademinë Ushtarake “Skënderbej” në specialitetin “Ndërlidhje”. Prej vitit 1991 e në vijim ka kryer detyra të ndryshme, duke përfshirë komandant toge në kompaninë e Ndërlidhjes Brk. Ersekë, komandant kompanie Ndërlidhje, në Repartin ushtarak nr.1515 Vlorë, më pas karriera e tij ka vijuar në garnizonin e Bunavisë, duke kryer detyra nga niveli i komandantit të togës, komandantit të kompanisë së Ndërlidhjes, komandantit të kompanisë së Shtabit. Në vitin 2003 për një periudhë të shkurtër kohe ka punuar në repartin ushtarak Mbyet, Fier dhe më pas në batalionin e këmbësorisë Poshnje, Berat.

Në nëntor 2003 me aktivizimin e Brigadës së Stërvitjes Bazë Bunavi është rikthyer në këtë repart, duke u caktuar në detyrën e komandantit të kompanisë së parë në batalionin e Dytë. Më tej karriera ushtarake e tij do vazhdojë si shef i Ndërlidhjes në Brigadën e Stërvitjes Bazë Bunavi, zëvendëskomandant në batalionin e parë të Qendrës së Stërvitjes Individuale, shef i Zyrës të Komandantit të Qendrës së Stërvitjes Individuale, shef i Personelit në Shkollën e Trupës, Bunavi, shef i Qendrës së Stërvitjes Individuale në Shkollën e Trupës dhe QSI. Në maj 2019 u emërua në detyrën e shefit të Shtabit në Shkollën e Trupës dhe QSI, detyrë që e kreu deri në muajin mars 2022. Në muajin mars 2022 u emërua në detyrën e Komandantit të Qendrës së Arsimimit Profesional të Ushtarëve. Me kalimin në strukturën e re në tetor 2022 u riemërua në po të njëjtën detyrë, të cilën vijon ta kryejë aktualisht.

Karriera ushtarake e nënkolonelit Bujar Fejzo është e lidhur me repartin ushtarak të Bunavisë, duke dhënë kontribute të rëndësishme dhe të qenësishme në transformimin e këtij reparti të rëndësishëm të FA-së të RSH.



Nënkolonel Bujar Fejzo/Komandant i QAPU

Gjatë kohës që ka punuar në Bunavi është aktivizuar në fushën e ndërlidhjes, stërvitjes, arsimimit dhe personelit, duke kontribuar si pjesë e grupeve të punës në disa procedura dhe manuale si “Manuali i Instruktorit të Stërvitjes”, “Kurrikula e Stërvitjes Individuale”, “Procedura standarde të testimit dhe vlerësimit të detyrave të stërvitjes individuale të ushtarit”, Rregulloren “Për Organizimin dhe Funksionimin e Qendrës së Arsimimit Profesional të Ushtarëve”, Rregulloren e “Vlerësimit të Kursantëve në Qendra Stërvitore të FA-së dhe në QAPU”.

Po kështu, kontribute të rëndësishme ka dhënë edhe gjatë proceseve transformuese të strukturës dhe infrastrukturës që ka pësuar reparti i Bunavisë gjatë këtyre rreth 30 viteve, në mënyrë të veçantë nga viti 2003 deri në vitin 2023. Është vlerësuar me medalje të ndryshme për arritje gjatë karrierës së tij të gjatë ushtarake, duke përfshirë: Medalje e Karrierës, Medalje e komandantit, Medalje e shërbimit.

• Komandant Fejzo, kur ka filluar aktivitetin Qendra?

Qendra e Arsimimit Profesional të Ushtarëve është krijuar në shkurt të vitit 2003 me emërtimin

institucioni ka qenë trajnimi i të rekrutuarve në FA, ku përfshihen kandidatët për ushtarë/detarë por edhe kandidatët për oficerë në disa vite. Qendra e Arsimimit Profesional të Ushtarëve (QAPU) aktualisht është institucioni i vetëm ushtarak, i cili përgatit dhe trajnon të gjithë kontingjentet e kandidatëve për ushtarë/detarë dhe ushtarëve në të dy komponentët e Stërvitjes Individuale, Stërvitjen Individuale Bazë dhe Stërvitjen Individuale të Avancuar.

Në fakt ky repart konsiderohet i “vjetër” për historikun e FA-së të Republikës së Shqipërisë pasi zanafilla e tij është në vitin 1964 dhe prej këtij viti reparti është transformuar në strukturë, infrastrukturë, emërtim, mision dhe sot konsiderohet një repart modern dhe i konsoliduar, duke përmbytur me sukses misionin e ngarkuar.

• Cili është misioni i saj?

QAPU drejton dhe menaxhon zhvillimin dhe vlerësimin e Stërvitjes Individuale Bazë me rekrutët kandidatë për ushtarë/detarë aktivë dhe Stërvitjes Individuale të Avancuar me ushtarët sipas specialiteteve.

• Çfarë transformimesh ka pësuar përgjatë rrugëtimit të saj?

Qendra e Arsimimit Profesional të Ushtarëve, ashtu si dhe Forcat e Armatosura të RSH, përgjatë këtyre viteve i është nënshtruar një procesi transformimi rrënjësor.

Pak histori

Qendra e Arsimimit Profesional të Ushtarëve është e dislokuar në territoret e dy njësive administrative të Bashkisë Vlorë, njësisë administrative Qendër dhe njësisë administrative Shushicë, në koordinatat gjeografike 41°31’10”, 19°30’43”.

Baza e Bunavisë është krijuar në vitin 1964 si Batalion Këmbësorie. Në vitet 1985 - 1990 ka funksionuar si Shkollë Instruksioni për përgatitjen e oficerëve në rezervë. Në vitet 1991-1996 ka funksionuar si Brigadë Këmbësorie. Në vitet 1996-2003 ka funksionuar përsëri si Batalion Këmbësorie, ndërsa në shtator 2003 është krijuar Brigada e Stërvitjes Bazë. Në vitin 2010 është krijuar Qendra e Stërvitjes Individuale dhe nga tetori i vitit 2012 deri në tetor të vitit 2020





ka funksionuar si Shkollë Trupe. Nga tetori i vitit 2020, emërtohet Qendra e Arsimitit Profesional të Ushtarëve, duke vijuar me po këtë emër.

Në rrugën e gjatë që nga krijimi dhe deri në ditët e sotme reparti ka pësuar ndryshime të rëndësishme dhe domethënëse falë përkujdesjes së Qeverisë Shqiptare, Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabit të Përgjithshëm, Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, sot Akademia e Forcave të Armatosura.

Në këtë rrugëtim plot sfida dhe vështirësi padyshim kontribut të qenësishëm kanë dhënë personeli i saj në vite që nga ushtari më i thjeshtë, nënoficerët, punonjësit civil dhe oficerët e të gjitha niveleve.

Gjej rastin të falënderoj dhe shpreh mirënjohjen time për kontributin e dhënë në vite për çdo efektiv të këtij reparti nga niveli më i ulët deri te titullarët e institucionit. Gjithçka kemi sot është falë punës, mundit, djersës, sakrificës, përkushtimit dhe kreativitetit të një numri të konsiderueshëm personash të cilët bënë të mundur që me punën e tyre t’i japin repartit të Bunavisë pamjen dhe emrin e nderuar dhe të respektuar që ka ky repart dhe me modesti themi nga më të mirët e FA-së.

• Çfarë ofron nga pikëpamja e infrastrukturës jetësore, administrative dhe stërvitore, Garnizoni i Bunavisë?

QAPU, në nivel kombëtar, përfaqëson një aset me vlerë, serioze dhe të besueshme, profesionale dhe e aftë të përmbushë detyrimet në përgatitjen e ushtarit profesionist të së ardhmes dhe synon të ofrojë standarde, cilësi, përgatitje bashkëkohore dhe përshtatje me kërkesat e Forcave të Armatosura dhe nevojave të tjera në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

Bunavia ofron akomodim, ushqim, larje, mjedise çlodhjeje dhe argëtimi, poligone për zhvillim të qitjeve, poligone të stërvitjes taktike, terrene sportive, sheshe dhe rajone stërvitore për çdo temë që zhvillohet, klasa, armatim dhe pajisje luftarake, bazë materiale dhe didaktike për stërvitje, shërbim shëndetësor 24 orë, furnizim me ujë, personel me eksperiencë në zhvillimin e programeve të ushtarit.

Kushtet jetësore

Akomodimi. Kapaciteti i përgjithshëm akomodues 500-600 vetë. 2 godina 3 katëshe të rikonstruara në vitet 2003-2004, dhe një godinë 4 kate (hotel) ndërtuar e re në vitin 2007.

Ushqimi. Në Bunavi funksionojnë kuzhina e gatimit, dhe mensa 2 kate me kapacitet 300 vende, të zgjeruara dhe rikonstruktura në vitin 2007. Gatimi dhe shpërndarja e ushqimit prej vitit 2007

bëhet me kontraktor privat.

Larja. Në garnizon funksionojnë dy kaldaja për larjen e efektivave, me naftë dhe gaz dhe një me panele diellorë, si dhe dushe të mjaftueshëm për larjen e efektivave. Larja e çarçafëve dhe teshave të ushtarëve bëhet me kontraktor privat.

Mjedise çlodhëse dhe kulturore. Në garnizonin Bunavi funksionon biblioteka me një fond të pasur librash dhe revistash artistike dhe gjithë literatura ushtarake e botuar nga FARSH. Gjithashtu, ka salla televizori, terrene sportive (fushë futbollit, minifutbollit, volejbollit, sallë force, mjediset janë të asfaltuara dhe përdoren gjerësisht për vrapim), ku mund të luajnë e të argëtohen dhjetëra kursantë njëkohësisht.

Infrastruktura stërvitore dhe kapacitetet e saj

Poligone për përgatitjen dhe zhvillimin e qitjeve. Në garnizonin Bunavi funksionojnë poligonet e qitjes për zhvillimin e përgatitjes për qitje me armët e këmbësorisë dhe zhvillimin e tyre,

operacioneve mbrojtëse, i operacioneve mësimëse, operacioneve asimetrike (pika e kontrollit, prita, lufta në qendrat e banuara, etj.)

Terrenet e përgatitjes fizike: janë në funksion Brezi i Kalitjes fizike me 12 elementë, vegla gjimnastikore, sheshi i luftimit trup me trup, fusha e futbollit, pista e vrap, kalçeto, fushë basketbolli, volejbollit.

Sheshe dhe rajone stërvitore: Sheshet dhe rajonet stërvitore mundësojnë zhvillimin e programeve të MKK, Xhenios, Topografisë, Ndërlidhjes. Ka dy sheshe të mëdha rreshtimi të asfaltuar, ku zhvillohen në kushte shume të mira temat e përgatitjes rreshtore.

Klasa: Vetëm në godinën e kursit SIA funksionojnë 4 klasa me kapacitet 30 vende dhe, po kaq të tilla janë në godinën e kursit SIB, dy salla me kapacitet 60 vende. Në godinën katërkatëshe janë nga 4 klasa në tre katet e kësaj godine. Në godinën e bibliotekës funksionojnë 2 salla me

• Cila është rëndësia e Stërvitjes Individuale dhe si zhvillohet ajo?

Stërvitja Individuale është stërvitje institucionale dhe është baza e nisjes për nivelet e tjera të stërvitjes që janë ajo e kompaktësimit në nivelet togë, kompani, batalion e më gjerë.

Në këtë lloj stërvitjeje, rekrutëve dhe ushtarëve u kërkohet aftësimi i tyre për të vepruar si individ, në nivel grupi dhe deri në skuadër.

Kursi i Stërvitjes Individuale Bazë (SIB) është kurs selektiv. Certifikimi në SIB përbën kushtin kryesor për të vijuar karrierën ushtarake në përbërje të trupës së ushtarëve të FARSH.

Stërvitja Individuale Bazë zhvillohet në QAPU, Bunavi, ajo zgjat 10 javë (3 javë kalendarike dhe 7 javë stërvitore) gjithsej 53 ditë.

Programi i Stërvitjes Individuale Bazë është i ndarë në 3 periudha: “jeshile”, “blu” e “kuqe”.

Stërvitja e programuar zhvillohet 6 orë në ditë. Programi i stërvitjes gjatë periudhës “jeshile”



të përshtatura për të gjithë qitjet që parashikohen në programet e SIB dhe SIA, si: qitjet me skuadër në mbrojtje dhe qitjet bashkërenduese në sulm. Në poligonet e qitjes realizohen qitjet me granata dore luftarake, qitjet me GHLKT, qitjet me mitraloz të lehtë dhe qitjet me automatik deri 200m. Qitjet natën realizohen në poligonin e qitjes natën. Qitjet me pistoletë realizohen në poligonin themelor. Në interes të përgatitjes së grupeve mësimore janë përshtatur dhjetëra sheshe për përgatitjen për qitje.

Poligone të stërvitjes taktike: Janë përshtatur sipas temave të programit SIA tre poligone taktike (nivel ushtar/skuadër/togë), poligoni i

kabinetet e gjuhës angleze (funksionale) me nga 20 vende, si dhe një kabinet për armët e zjarrit me kapacitet 30 vende.

Armatimi, Teknika dhe Pajisjet luftarake: Në Bunavi mbështet me armatim, pajisje luftarake i gjithë programi stërvitor i SIB dhe SIA-s për specialitetin këmbësori, logjistikë, shëndetësi.

Baza materiale e didaktike për stërvitjen: baza materiale e lëvizshme ekzistuese në Bunavi mbështet pothuajse plotësisht programet e SIB dhe SIA-s për specialitete Këmbësori, MKK, Xhenio, Ndërlidhje, Logjistikë, Polici Ushtarake, Shëndetësi, etj.

zhvillohet në 3 javë kalendarike, nga dita e hënë deri ditën e shtunë pa ndërprerje. Kjo periudhë zgjat 21 ditë kalendarike përfshi edhe ditët e diela, nga ku 18 ditë janë të mirëfillta stërvitore.

Çdo javë është me 6 ditë stërvitore, nga ku përfshihet zhvillimi i stërvitjes së programuar edhe ditën e shtunë.

Ditën e diel planëzohen aktivitete dhe veprimtari të përbashkëta në bazë n/reparti si: stërvitje bashkëvepruese, stërvitje ndreqës, stërvitje përmirësuese, aktivitete dhe veprimtari sportive, tranazhe, veprime të përbashkëta me këngë dhe me hap rreshtor, mësimi i himnit

kombëtar dhe himni i repartit, shkundja e batanijeve dhe nxjerrja e tyre në diell, pastrime të përgjithshme etj.

Gjatë kryerjes së kësaj periudhe stërvitore ndalohet në mënyrë kategorike planëzimi i rekrutëve me leje.

Kohëzgjatja e periudhës “blu” është 18 ditë stërvitore, kurse kohëzgjatja programit të periudhës së “kuqe” është 17 ditë stërvitore, përfshi edhe ditën e ceremonisë së certifikimit dhe të betimit të rekrutëve.

Gjatë këtyre periudhave stërvitore (blu dhe të kuqe), programi i stërvitjes zhvillohet 5 ditë në javë nga e hëna deri të premte, si dhe kursantët mund të planëzohen me leje pranë familjes.

Në fund të çdo periudhe stërvitore kursantët merren në testimin e detyrave nga komisionet testuese sipas urdhrave, procedurave dhe udhëzimeve përkatëse.

• A është niveli dhe performanca e kontingjentit të rekrutëve gati për ushtarë të denjë për të shërbyer në Forcat e Armatosura?

Kam të freskët në kujtesën time ditët e para që erdhën rekrutët këtu në Bunavi, ku konstatoja djem dhe vajza të ndrojtur, pak të ngathët, me qëndrim pasiv dhe me veprime individuale, një pjesë edhe me një fizik jo shumë premtues, disa prej të cilëve nuk i përballuan kërkesat dhe ngarkesën dhe u tërhoqën.

Procesi i transformimit dhe përshtatjes të rekrutëve kandidatë për ushtarë/detarë është sfida jonë dhe ne për këtë gjë jemi përgatitur. Ai është një proces i vështirë, që kërkon lodhje mendore dhe fizike si nga ana e rekrutëve po ashtu edhe personelit trajnues. Stërvitja duhet të vijë graduale, ashtu si vetë procesi transformues, ku dashuria/dëshira dhe përkushtimi për të shërbyer në Forcat e Armatosura duhet të bëhet pjesë dominante e gjithë këtij procesi.

Ajo që konstatojmë me kënaqësi sot, është se ne kemi rekrutë të përgatitur me formimin e duhur ushtarak, të cilët meritojnë të jenë ushtarë të denjë të Forcave të Armatosura. Ata shfaqen më të fortë fizikisht, të përgatitur nga ana ushtarake, më të disiplinuar, më bashkëpunues, më të përlur, më dinjitoz, duke mbartur në vetvete disa cilësi dhe aftësi që fitohen vetëm në QAPU dhe kursin e Stërvitjes Individuale Bazë.

• A disponohen të gjitha materialet dhe armët e duhura për realizimin me efikasitet të stërvitjeve tuaja?

Në garnizonin e Bunavisë dhe respektivisht kurset SIB dhe SIA mbështeten me armatim, pajisje luftarake i gjithë programi stërvitor i SIB dhe SIA-s për specialitetin këmbësori, logjistikë, shëndetësi, ndërlidhje, xhenio, polici ushtarak. Në programin stërvitor është i përfshirë dhe zhvillohen njohuri për armatimin e ri standard i NATO-s, pushkën automatike “Berreta”, 5.54 mm AR 70/90, mitralozin e lehte Mg-4, mitralozin e rëndë Mg-5, gjithashtu janë programuar dhe zhvillohen qitje me këtë lloj armatimi.

Baza materiale e didaktike për stërvitjen ekzistuese në Bunavi mbështet pothuajse plotësisht programet e SIB dhe SIA-s për specialitete Këmbësori, MKK, Xhenio, Ndërlidhje, Logjistikë, Shëndetësi, etj.

Në planin afatgjatë të zhvillimit të AFA-së dhe QAPU-së janë parashikuar fonde dhe kërkesa për kompletimin me armatimin e ri të NATO-s, armatim të cilin e kanë në përdorim repartet operacionale të FA-së si mortajtat M-60 dhe M-81, GHLKT, Bereta PX- 4 .

• Cilat janë programet e përgatitura për të gjitha specialitetet, dhe sa është kohëzgjatja e

tyre?

Qendra e Arsimimit Profesional të Ushtarëve zhvillon dy programet e Stërvitjes Individuale të cilat janë: Programi i Stërvitjes Individuale Bazë, i cili zhvillohet me të rekrutuarit rishtas në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe Programin e Stërvitjes Individuale të Avancuar sipas specialiteteve dhe që kryhet nga ushtarët që kanë kryer Stërvitjen Bazë përjashtuar specialitetin “Detari”.

Programi i Stërvitjes Individuale Bazë (SIB) është 10 javë kalendarike ose 53 ditë stërvitore. Qëllimi i këtij programi është transformimi i civilëve të rekrutuar në FA në individë me disiplinë ushtarake, të motivuar, të përgatitur moralisht dhe fizikisht në përmbushjen e detyrave operacionale deri në nivel grupi. Programi mësimor ka 12 lëndë dhe në përfundim të këtij programi nga pjesëmarrësit kërkohet të arrihen disa standarde si: përdorimi me lehtësi i armëve të lehta të këmbësorisë, rezultate të mira në qitje, performancë e mirë në zgjidhjen e detyrave operacionale nga niveli individual deri në nivel grupi, nivel i lartë kondicioni fizik për çdo rekrut, përgatitje fizike çdo ditë në program.

Në fund të çdo periudhe rekrutët testohen në detyra të ndryshme për çdo lëndë mësimore. Kursantët që nuk arrijnë standardet nuk kualifikohen.

Programi i Stërvitjes Individuale të Avancuar



(SIA) është 10 javë kalendarike ose 50 ditë stërvitore dhe zhvillohet me ushtarët aktiv, që kanë kryer SIB, përjashtuar specialitetin detari.

Qëllimi i këtij programi është përgatitje ushtarakë, fizike, psikologjike për çdo ushtar aktiv në situata luftimi për të zhvilluar detyra operacionale nga niveli individual deri në nivel skuadre.

SIA zhvillohet në specialitetet: Këmbësori, Logjistikë, Ndërlidhje, Polici Ushtarakë, Xhenio. Aftësitë, cilësitë dhe shprehitë (kompetencat) themelore që kërkohen në përfundim të programit Aftësi të plota profesionale në specialitetin përkatës; Aftësi të plota për të luftuar në operacione luftarake dhe jo luftarake; Aftësi bazë për udhëheqjen e grupit; Kondicion psiko-fizik për të përballuar ngarkesa në operacion; Qitës efektiv dhe bashkëveprues në qitjet me skuadrën; Aftësi në dhënien e ndihmës së parë vetes dhe shokut të dëmtuar; Bashkëveprues në grup; Komunikim efikas me gojë.

• Cilat janë përparësitë e procesit certifikues

nga Qendra e Arsimimit Profesional të Ushtarëve?

Krahasuar me njësitë e repartet e FA-së, Qendra e Arsimimit Profesional të Ushtarëve garanton infrastrukturën jetësore dhe stërvitore sipas standardeve, me kapacitete dhe cilësi më të larta se në njësi/reparte të FA-së.

Ofron përvojën e duhur për trajtimin e kursantëve dhe zhvillimin e stërvitjes individuale me ushtarët profesionistë në të dy komponentët e saj, SIB dhe SIA.

Ofron kushtet optimale për zhvillimin e stërvitjes së ushtarit profesionist me regjim 24 orësh dhe sipas standardeve të përcaktuara, duke i krijuar mjedisin e duhur për trajtim dhe trajnim të njëllojtë për të gjithë trupën e ushtarëve të FA-së, (në pikëpamjet të procedurave të trajtimit, procedurave të zhvillimit të stërvitjes dhe testimitt).

Garanton një proces dhe produktivitet më cilësor të stërvitjes, pasi kryhet e përqendruar në një strukturë të vetme dhe të specializuar stërvitore dhe jo e fraksionuar në qendrat stërvitore në njësitë e repartet e FA-së.

Ofron një trupë instruktorësh me eksperiencë shumëvjeçare në zhvillimin e kësaj stërvitjeje. Ofron mjedise e kapacitete stërvitore të bollshme për stërvitjen sipas standardeve. Ofron mjedise çlodhëse të bollshme dhe në standarde optimale.

• Cili është vizioni juaj për të ardhmen e Qendrës së Arsimimit Profesional të Ushtarëve?

Qendra e Arsimimit Profesional të Ushtarëve do të vijojë të jetë qendër trajnimi për të gjithë kandidatët që rekrutohen në FA të RSH. Do të zhvillojë dhe konsolidojë më tej nivelin e përgatitjes së ushtarit të FA-së në dy komponentët e saj: Stërvitjen Individuale Bazë dhe Stërvitjen Individuale të Avancuar;

Zhvillimi i Stërvitjes Individuale të ushtarit në të dy komponentët e saj SIB dhe SIA të bëhet vetëm në QAPU, Bunavi; Zhvillimin e tre kurseve të SIB gjatë një viti me 156 rekrutë për secilin kurs dhe tre kurse të SIA me nga 120 ushtarë për secilin kurs, sa kapacitetet aktuale trajnuese të tyre, me produkt vjetor 468 rekrutë në SIB dhe 360 ushtarë në SIA, ose gjithsej 828 të trajnuar.

Realizimi i një planifikimi konkret, objektiv dhe të realizueshëm, në termat afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë, mbështetur në burime të mjaftueshme në aspektin e kapaciteteve njerëzore, infrastrukturore, kurrikulare e programore, me qëllim zhvillimin e suksesshëm të programeve

të stërvitjes individuale, do të bëhet nëpërmjet përqendrimit në objektiva konkretë të cilët do të përfshijnë tre drejtimet kryesore:

- Struktura
- Infrastruktura/modernizimi
- Programe

Në aspektin strukturor, synohet forcimi i strukturës aktuale (faza e parë) dhe pas një periudhe 2-3-vjeçare (faza e dytë), rishikim i saj, me qëllim përcaktimin e saktë të përgjegjësive të QAPU, si dhe lidhjen e gjithë sistemit të stërvitjes të FA-ve me QAPU-në.

Një nga objektivat madhorë do të jetë infrastruktura, ndërhyrjet, përshtatjet në objektet kryesore ku akomodohen efektivat, përmirësimi i kushteve të jetesës të efektivave dhe modernizimi.

Kjo nismë është nevojë e rëndësishme e QAPU-së dhe në përputhje me vizionin dhe planin afatmesëm dhe afatgjatë të FARSH, me synim që të arrijë: sigurimin e hapësirave të nevojshme me infrastrukturë bashkëkohore për stërvitje, trajnim, argëtim dhe shërbime të tjera ndihmëse, në funksion të përmbushjes së misionit të QAPU-së dhe detyrave që rrjedhin prej tij, përmirësimin e kushteve të punës, jetesës, shëndetit, procesit stërvitor dhe sigurisë së personelit, në funksion të cilësisë së stërvitjes, trajnimit dhe kualifikimit.

Qendra e Arsimimit Profesional të Ushtarëve synon që ndërhyrjet në infrastrukturën aktuale por

edhe ndërtimet e reja, modernizimi i ambienteve akomoduese, mjeteve të transportit, armatimit të ri, të përfundojnë brenda një periudhe 10-vjeçare e ndarë në tre faza, të cilat do të zhvillohen bazuar në master-planin aktual, hartimin e projekteve përkatëse dhe financimin e tyre në vite.

Në kushtet e transformimit dhe konsolidimit të plotë institucional, QAPU do të ketë si përparësi që zhvillimi kurrikular dhe ai i programeve të bëhet me synim: ndryshimet e nevojshme të diktua nga problematikat e evidentuara gjatë zbatimit në praktikë të programeve dhe mësimëve të nxjerra; harmonizimin e programeve me kërkesat dhe nevojat e stërvitjeve pasardhëse në repartet operacionale; përshtatja e tyre me kërkesat, standardet dhe eksperiencat e reja që ofrojnë veprimet luftarake në ditët e sotme.

Me infrastrukturën që ka dhe pozicionin e saj gjeografik, baza e Bunavisë duhet vlerësuar dhe përdorur jo vetëm për misionin aktual që ka por edhe për stërvitjen bazë/fillestare të kontingjenteve që hyjnë rishtas në strukturat e tjera ligj-zbatuese, apo edhe më gjerë.

PËRSHTATI: MIMOZA GOLIKJA

Ndërsa vazhdojnë përgatitjet për Samitin e NATO-s në Vilnius, Lituani, ku Aleanca do të mbledhet për të trajtuar një sërë çështjesh, kjo javë që po lemë pas është dominuar nga ngjarje e takime të rëndësishme të Sekretarit të Përgjithshëm Jens Stoltenberg në vendet aleate dhe në selinë e NATO-s në Bruksel. Në qendër të bisedimeve ka qenë parandalimi dhe mbrojtja e Aleancës, forcimi i krahut lindor të Aleancës dhe jo vetëm, situata e luftës në Ukrainë dhe forcimi i mbështetjes për të, situata në Ballkanin Perëndimor në veriun e Kosovës dhe misioni i KFOR-it, rritja e buxhetit të Mbrojtjes, rritja e pranisë dhe gatishmëria, nga Deti i Zi në Detin Baltik, etj.

Por NATO po monitoron gjithashtu edhe situatën në Rusi me rebelimin e grupit “Wagner” të ndodhur atje. Duke e filluar javën me një vizitë në Vilnius, Sekretari i Përgjithshëm Jens Stoltenberg, teksa falënderoi presidentin Gitanas Nauseda për kontributet e shumta të Lituanisë në NATO dhe për pritjen e Samitit të ardhshëm të Aleancës tha se: “Ne po monitorojmë situatën në Rusi. Ngjarjet e fundjavës janë një çështje e brendshme ruse dhe një tjetër demonstrim i gabimit të madh strategjik që Presidenti Putin bëri me aneksimin e tij të paligjshëm të Krimesë dhe luftën kundër Ukrainës. Ndërsa Rusia vazhdon sulmin e saj, është edhe më e rëndësishme të vazhdojmë mbështetjen tonë për Ukrainën”. Sekretari i Përgjithshëm dënoi gjithashtu njoftimin e Rusisë për vendosjen e armëve bërthamore në Bjellorusi, duke e quajtur atë “të pamatur dhe të papërgjegjshëm”. Aleanca nuk po sheh asnjë tregues se Rusia po përgatitet të përdorë armë bërthamore, por NATO mbetet vigjilente. “Nëse Rusia mendon se mund të na frikësojë të mbështesim Ukrainën, ajo do të dështojë”, - tha z. Stoltenberg.

Samiti në Vilnius është në përgatitjet përfundimtare dhe ai do të zhvillohet më 11 dhe 12 korrik.

NATO, gati të mbrojë çdo centimetër të territorit aleat

Gjatë vizitës në Lituani, Sekretari i Përgjithshëm vizitoi edhe Pabrade, ku takoi trupat gjermane dhe lituaneze që stërviteshin së bashku në stërvitjen “Griffin Storm”. Së bashku me të, teksa vizitonte trupat ushtarake gjatë stërvitjes, ishin edhe presidenti Gitanas Nauseda dhe ministri gjerman i Mbrojtjes, Boris Pistorius.

Stërvitja testoi përforcimin e shpejtë të grupit luftarak të NATO-s të udhëhequr nga Gjermania në madhësinë e brigadës, siç u ra dakord në Samitin e Madridit të NATO-s në vitin 2022. “Kjo stërvitje dërgon një mesazh të qartë se NATO është gati të mbrojë çdo centimetër të territorit aleat”, - tha Stoltenberg. Ai shtoi se: “Ne po demonstrojmë se mund të përforcohemi shpejt, sa herë që nevojitet”.

“Në Samitin e Vilniusit, aleatët do të miratojnë plane të reja rajonale me forca dhe aftësi specifike të caktuara për mbrojtjen e aleatëve të veçantë”, - tha Sekretari i Përgjithshëm. Ai shtoi se forcat do të stërviten së bashku rregullisht dhe vuri në dukje se NATO tani ka rënë dakord gjithashtu për një model të ri rrotullues për mbrojtjen ajrore dhe raketore.

“Aderimi i Finlandës dhe Suedisë në NATO do të forcojë më tej sigurinë e Baltikut”, - tha Sekretari i Përgjithshëm. “Unë fola dje me Presidentin Erdogan dhe jam gjithashtu në kontakt me qeverinë suedeze dhe finlandeze. Dhe ne ramë dakord që të thërrasim një takim të nivelit të lartë në Bruksel përpara Samitit. Në këtë takim do të përfshihen ministrat e Jashtëm, shefat e inteligjencës dhe këshilltarët e sigurisë kombëtare”, specifikoi shefi i NATO-s. “Qëllimi është të arrihet përparim në përfundimin e anëtarësimit të Suedisë në NATO”.

Mbështetja për Ukrainën do të jetë gjithashtu një prioritet kryesor për Samitin, dhe Stoltenberg vlerësoi Gjermaninë dhe Lituaninë për ofrimin e mbështetjes dhe trajnimit kritik, duke thënë se kjo “ndihmon të shpëtojë jetë çdo ditë”. Në Samitin e Vilniusit, aleatët do të miratojnë një paketë ndihme shumëvjeçare dhe do të përmirësojnë lidhjet politike me Ukrainën. “Kjo do të ndihmojë në afrimin e vendit me vendin që i takon në NATO”, - tha Sekretari i Përgjithshëm.

“Ne nuk duhet të nënvlerësojmë Rusinë”

Një ditë më pas, pas vizitës së tij në Vilnius, Sekretari i Përgjithshëm Stoltenberg ftoi së bashku krerët e shtatë aleatëve të NATO-s në Hagë, për të ndihmuar në përgatitjen e Samitit të Aleancës në Vilnius. Takimi u organizua bashkë me kryeministrin holandez Mark Rutte dhe përfshinte kryeministrin e Shqipërisë, Edi Rama, kryeministrin Alexander De Croo të Belgjikës, kryeministrin Jonas Gahr Støre të Norvegjisë, presidentin Gitanas Nauseda të Lituanisë, presidentin Andrzej Duda të Polonisë dhe presidentin Klaus Iohannis të Rumanisë.

Duke komentuar ngjarjet në Rusi gjatë ditëve të fundit, Sekretari i Përgjithshëm tha se: “këto janë çështje të brendshme ruse, por është më së miri e qartë se lufta e paligjshme e Presidentit Putin kundër Ukrainës ka thelluar ndarjet dhe ka krijuar tensione në Rusi. Por, ne nuk duhet të nënvlerësojmë Rusinë, kështu që është edhe më e rëndësishme që të vazhdojmë të mbështesim Ukrainën”.

Sekretari i Përgjithshëm theksoi se Samiti do të dërgojë një mesazh të qartë përkushtimi ndaj Ukrainës. Ai falënderoi Holandën dhe aleatët e tjerë të pranishëm për ofrimin e mbështetjes kritike, duke përfshirë kontributet në Paketën Gjithëpërfshirëse të Ndihmës së NATO-s dhe trajnimitin e pilotëve ukrainas në avionët F-16. Ai tha se Samiti i Vilniusit do të pajtohet me një program

Përgatitjet për Samitin e NATO-s në Vilnius, Lituani, NATO forcon krahun Lindor të Aleancës



shumëvjeçar për Ukrainën dhe do të përmirësojë lidhjet politike, duke e sjellë Ukrainën më afër vendit të saj të merituar në NATO.

Takimi trajtoi gjithashtu hapat e ardhshëm të NATO-s për të forcuar parandalimin dhe mbrojtjen e Aleancës, si dhe një premtim më ambicioz për investime në mbrojtje. “Lufta e Rusisë në Ukrainë tregon se ne nuk mund ta marrim paqen si të mirëqenë dhe se duhet të investojmë më shumë në mbrojtjen tonë”, - përfundoi Sekretari i Përgjithshëm Stoltenberg.

Prania dhe gatishmëria nga Deti i Zi në Detin Baltik

Rebelimit të fundjavës së kaluar nga mercenarët Wagner në Rusi, Sekretari i Përgjithshëm iu drejtua sërish edhe kur priti kryeministrin e Estonisë Kaja Kallas në selinë e NATO-s, më 28 qershor 2023, gjithashtu në takim për përgatitjen e Samitit të Vilniusit. Stoltenberg e theksoi përsëri duke e quajtur rebelimin e “Wagner” një çështje të brendshme për Rusinë, por nënvizoi se ajo tregon edhe një herë se lufta e paligjshme e Presidentit Putin në Ukrainë është një gabim i madh strategjik. Ajo ka thelluar ndarjet ekzistuese dhe ka krijuar tensione të reja në Rusi. Në të njëjtën kohë, ai riparalajmëroi kundër nënvlerësimit të Rusisë, duke thënë se: “Ne duhet të vazhdojmë të mbështesim Ukrainën dhe duhet ta mbajmë të fortë mbrojtjen tonë”. Që nga viti 2014, NATO ka përforcuar ndjeshëm praninë dhe gatishmërinë e saj nga Deti i Zi në Detin Baltik. Kjo përfshin gjithashtu grupin luftarak shumëkombësh të udhëhequr nga Mbretëria e Bashkuar në Estoni, i cili mund të përforcohet me shpejtësi deri në fuqinë e brigadës, si dhe avionët luftarakë dhe mbrojtjen ajrore nga aleatët që ndihmojnë në mbrojtjen e qiejve të Estonisë. Sekretari i Përgjithshëm tha se aleatët kanë rënë dakord për një model të ri rrotullues për mbrojtjen ajrore dhe raketore, duke lejuar kalimin e shpejtë nga policia ajrore në mbrojtjen ajrore. “Në samit, ne do të ndërmarrim hapat e ardhshëm, me plane të reja rajonale, forca dhe aftësi të caktuara, dhe një program të zgjeruar stërvitjeje, të gjitha të mbështetura nga mbi 300 000 trupa në gatishmëri të lartë”, - tha Sekretari i Përgjithshëm.

Mbështetja për Ukrainën do të jetë një tjetër prioritet kryesor për Samitin dhe z. Stoltenberg përshëndeti rolin udhëheqës të Estonisë në ofrimin e ndihmës kritike dhe mbështetjen e komunitetit ndërkombëtar ndaj popullit ukrainas. Ai tha se në samit, aleatët do të bien dakord për një paketë shumëvjeçare ndihme dhe do të përmirësojnë lidhjet politike me Ukrainën, duke e sjellë vendin më afër vendit të tij të merituar në NATO. Aleatët pritet gjithashtu të bien dakord për një premtim më ambicioz për investimet e mbrojtjes, me 2 për qind të PBB-së si një dysheme, jo një tavan, përsëriti nevojën e investimeve në mbrojtje. Sekretari i Përgjithshëm dhe vlerësoi Estoninë për shembullin e saj. Ai shtoi se Samiti i Vilniusit do të jetë i pari për Finlandën si anëtare dhe shtoi se po punohet për të finalizuar edhe pranimin e Suedisë. “Kam thirrur një takim tjetër të zyrtarëve të lartë nga Turqia, Suedia dhe Finlanda para samitit. Tani është koha për të mirëpritur Suedinë si një anëtare e plotë e NATO-s”, - tha ai. Por Sekretari i Përgjithshëm nuk la pa përmendur situatën në Veri të Kosovës dhe ai foli për rëndësinë e misionit të KFOR-it të NATO-s në Kosovë, i cili vazhdon të përmbushë mandatin e OKB-së në mënyrë të paanshme. “Ne u bëjmë thirrje të dyja palëve që të përmbahen nga çdo gjë që mund të përshkallëzojë

më tej tensionet dhe të kthehen menjëherë në dialogun e lehtësuar nga BE-ja, që është e vetmja rrugë përpara”, - tha ai.

Franca do të rrisë shpenzimet e mbrojtjes me më shumë se një të tretën

Të rëndësishme janë kontributet e Francës në NATO dhe Sekretari i Përgjithshëm e vlerësoi këtë teksa ai u takua me Presidentin e Francës, Emmanuel Macron, në Paris, më 28 qershor 2023, për të diskutuar gjithashtu përgatitjet përfundimtare për Samitin e NATO-s në Vilnius pas dy javësh në korrik. Z. Stoltenberg falënderoi presidentin Macron për ndihmën jetike të Francës për Ukrainën, ndërsa ajo po mbron veten kundër luftës së agresionit të Rusisë. Ai theksoi nevojën për të vazhduar mbështetjen e Ukrainës, e cila do të jetë një temë kryesore në axhendën e Samitit. Stoltenberg përgëzoi Francën për udhëheqjen e grupit të betejës shumëkombëshe të NATO-s në Rumani, si dhe për kontributet e tjera në parandalimin dhe mbrojtjen e Aleancës. Ai theksoi gjithashtu se Franca do të rrisë shpenzimet e mbrojtjes me më shumë se një të tretën në vitet e ardhshme. Sekretari i Përgjithshëm tha se bashkëpunimi NATO-BE është më i rëndësishëm se kurrë në këtë moment të rëndë për sigurinë evropiane dhe përshëndeti angazhimin e fortë të Francës për forcimin e mëtejshëm të këtij partneriteti strategjik.

“Është një mundësi e shkëlqyer për t’ju takuar pak përpara Samitit të NATO-s në Vilnius dhe për të diskutuar përgatitjet përfundimtare për takimin e ardhshëm të NATO-s”, - tha në deklaratën e përbashkët për shtyp Sekretari i Përgjithshëm që mbajti me Presidentin e Republikës franceze, Emmanuel Macron. “Ne do të marrim vendime për të mbrojtur sigurinë tonë në jetë botë më të rrezikshme”, dhe ai përmendi sërish rebelimin e fundit nga mercenarët e Wagner-it në Rusi, si një çështje e brendshme për Rusinë, dhe që në të njëjtën kohë, tregon luftën e paligjshme e Presidentit Putin kundër Ukrainës, si një gabim i madh strategjik që ka thelluar ndarjet dhe ka që krijuar tensione të reja në Rusi. “Por ne nuk duhet të nënvlerësojmë Rusinë dhe ne duhet të vazhdojmë t’i ofrojmë mbështetje Ukrainës. Sepse sa më shumë tokë të jetë në gjendje të çlirojë Ukrainën, aq më e fortë do të jetë në tryezën e bisedimeve dhe aq më i mirë do të jetë shansi për një paqe të drejtë dhe të qëndrueshme. Prandaj përgëzoj dhe vlerësoj kontributet jetike të Francës në Ukrainë, duke përfshirë pajisjet jetike ushtarake dhe mbështetjen ekonomike”.

Bashkëpunimi NATO-BE është kyç për t’iu përgjigjur sfidave kryesore të sigurisë

Sekretari i Përgjithshëm vlerësoi partneritetin mes NATO-s dhe Bashkimit Evropian, i cili ka arritur nivele të paprecedentë. Ai e përshkroi atë si çelësin për mbështetjen e vazhdueshme për Ukrainën dhe për t’iu përgjigjur sfidave të tjera kritike. Z. Stoltenberg përshëndeti bashkëpunimin NATO-BE për qëndrueshmërinë e infrastrukturës kritike dhe publikimin e raportit të vlerësimit të Task Forcës NATO-BE. Ai falënderoi Komisionin Evropian dhe Shërbimin Evropian të Veprimit të Jashtëm për punën e përbashkët me NATO-n mbi raportin, i cili sugjeron mënyra konkrete për zhvillimin e mëtejshëm të lidhjeve, duke përfshirë më shumë shkëmbime informacioni; punën për të identifikuar rrugët alternative të transportit për lëvizshmërinë civile dhe ushtarake; dhe lidhje më të ngushta në kërkimin e sigurisë.

“Falënderoj Presidenten von der Leyen për udhëheqjen e saj dhe Komisionin Evropian dhe Shërbimin Evropian të Veprimit të Jashtëm për mbështetjen e tyre si pjesë e Task Forcës NATO-BE për qëndrueshmërinë e infrastrukturës kritike. Ky është një shembull i shkëlqyer i bashkëpunimit tonë në veprim. Raporti i Task Forcës përcakton rëndësinë e qëndrueshmërisë në energji, transport, infrastrukturë dixhitale dhe hapësirë, dhe jep një numër rekomandimesh kyçe për të thelluar edhe më shumë bashkëpunimin NATO-BE”, - tha Stoltenberg. Sekretari i Përgjithshëm po ashtu nënvizoi fokusin e përbashkët të NATO-s dhe BE-së në situatën në Kosovë. Ai theksoi se misioni i KFOR-it i drejtuar nga NATO vazhdon të zbatojë mandatin e tij të OKB-së në mënyrë të paanshme. Ai i bëri thirrje Beogradit dhe Prishtinës që të shmangin përshkallëzimin dhe të kthehen në dialogun e lehtësuar nga BE.

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s ishte pjesëmarrës në Këshillin Evropian, më 29 qershor 2023, me ftesë të Presidentit të Këshillit Evropian Charles Michel. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, më 29 qershor 2023 priti në selinë e NATO-s Kryeministrin e Bullgarisë, z. Nikolai Denkov. Diskutimi u fokusua në përgatitjen e Samitit të NATO-s në Vilnius, në situatën aktuale të sigurisë dhe në forcimin e mbështetjes të NATO-s për Ukrainën. Ata dhanë një konferencë të përbashkët për shtyp pas takimit të tyre.

Prigozhin, një mercenar i dehur



KOLONEL HYSNI GJERGJI

Mercenarët, siç i kam analizuar në një shkrim të fillim-marsit 2023, “Mercenarët, e ardhmja apo e shkuara e luftës”, janë ushtarë për para, ose “pata të egra” që shtegtojnë atje ku ka gjak, luftëra dhe konflikte në shkëmbim të parasë. Historia i njeh rastet kur “të punësuarit”, që janë mercenarët ngrihen dhe rebelohen, kundër punëdhënësve të tyre, ose nga pakënaqësia e trajtimit ose nga egoja dhe “dehja” që ata fitojnë gjatë betejave. Paraja dhe plaçka e luftës jo gjithmonë i mjafton atyre dhe kështu ata synojnë pushtetin politik. Mercenarët janë vrasësit me pagesë që shtetet përdorin për të fshehur dorën e tyre nga krimi. Fakti që ata nuk mbajnë flamur shtetëror, i bën ata të “mohueshëm” përballë akuzave shtetërore, duke i quajtur sipërmarrës privatë dhe në këtë mënyrë edhe përgjegjësia para ligjit është personale.

Prigozhin është një rast tipik i një mercenari në “delir” që ka gjithçka tjetër por i mungon pushteti. Dikur i turpshëm nga media, aktualisht është bërë fytyra e luftës së Rusisë kundër Ukrainës. Rritja e publicitetit të tij ka shkaktuar spekulime për ambiciet e mundshme politike. Sipas faqes së pavarur ruse të internetit Meduza, Prigozhin po planifikonte të niste një lëvizje patriotike dhe konservatore që përfundimisht do të evoluonte në një parti politike. Ambiciet e Prigozhin në arenën politike mund të dëmtojnë marrëdhëniet e tij me Kremlinin. Vëzhguesit e politikës së brendshme ruse nuk e vërejnë Prigozhin si pasardhës të Putin, por vazhdues më konservator se ai. Rusët europianë dhe paqësorë nuk mund ta pëlqejnë demagogjinë e tij politike, sulmet e tij ndaj institucioneve zyrtare, apo përpjekjet e tij për të kërcënuar stafin e Putinit, duke kërcënuar se do të formojë një parti politike, vetëm për ambicie personale.

I lindur në vitin 1961, në atë që ishte Leningradi i atëhershëm dhe tani është Shën Petersburg, Prigozhin i kaloi të 20-at e tij në një burg sovjetik, ku kreu nëntë vjet për grabitje dhe mashtrim. Në vitin 1980 shiste hotdog me karrocë në qytetin e tij të lindjes dhe papritur, më vonë u përfshi në projekte më të mëdha, si një restorant luksoz në Shën Petersburg, i cili u bë qendër për elitat ruse, duke përfshirë edhe nënkryetarin e atëhershëm Vladimir Putin. Siç ndodh në vende të ngjashme me Rusinë, përfiton nga lidhjet e ngushta me elitat politike, dhe biznesi i Prigozhin u zgjerua shumë, pasi Putin u bë president. Në vitin 2014, Prigozhin krijoi një kompani private ushtarake “Wagner Group”.

Putini dhe Prigozhin kanë fillime relativisht të ngjashme, pasi si shefi i “Wagner-it” ashtu dhe Presidenti Putin u rritën në lagjet më të vështira të Shën Petersburgut. Ata njihen që nga vitet 1990, por transformimi i tij në një komandant brutal lufte erdhi si pasojë e lëvizjes separatiste të vitit 2014 të mbështetur nga Rusia në Donbas në Ukrainën lindore. Prigozhin themeloi “Wagnerin” si një grup mercenarësh në hije që luftoi si në Ukrainë ashtu edhe, gjithnjë e më shumë, për



kauza të mbështetura nga Rusia në mbarë botën. CNN ka gjurmuar mercenarët e “Wagner” në Republikën e Afrikës Qendrore, Sudan, Libi, Mozambik, Ukrainë dhe Siri. Gjatë viteve ata kanë një reputacion të tmerrshëm dhe janë lidhur me abuzime të shumta të të drejtave të njeriut.

“Wagner” është i njohur për mizorinë dhe taktikat e tij brutale në fushën e betejës. Grupi ka demonstruar gjithashtu pamëshirshmërinë e tij jashtë fushëbetjës në videot e ekzekutimeve të supozuara të luftëtarëve të saj që dezertuan në Ukrainë. “Wagner” miratoi “varenë” si simbolin e saj pasi thuhet se e përdori atë për të ekzekutuar me thyerje të kafkës, një dezertor nga radhët e grupit vitin e kaluar. Mizoria e dukshme është pjesë e asaj që ofron Prigozhin. “Çfarëdo që të jetë, një pjesë e vënë në skenë, propagandë ose performancë e vërtetë, ajo promovon një kult të dhunës”, shkruan Andrei Kolesnikov, një bashkëpunëtor i lartë në Carnegie Endowment për Paqen Ndërkombëtare, në median e pavarur “Novaya Gazeta”. Kompanisë së tij të hotelerisë “Concord”, e themeluar në vitet 1990, iu dha kontrata ekskluzive dhe fitimprurëse qeveritare për darkat shtetërore, duke përfshirë ceremoninë e inaugurimit të Putinit dhe një vizitë të Presidentit të SHBA-së, George W. Bush në Shën Petersburg, duke u quajtur “kuzhinieri i Putinit”.

Ashtu si me fushatat dezinformuese për zgjedhjet në SHBA, ai mohoi prej kohësh çdo përfshirje me grupin, deri në shtator 2022, kur ai pranoi se kishte formuar njësinë. Më 14 shkurt 2023 Prigozhin pranoi se ishte pas një fushatë të gjerë dezinformimi për të ndikuar në rezultatet

e zgjedhjeve në SHBA. Akuzat më parë ishin mohuar ashpër nga Prigozhin dhe avokatët e tij, të cilët kanë ndërmarrë veprime ligjore kundër gazetarëve që shkruanin për lidhjen e tij me fermat ruse “troll”. Alexandra Prokopenko, një analiste e pavarur ruse, tha për DW atëherë se grupi mercenar i Prigozhin po ofronte “shërbime gri” për Putinin, që do të thotë, kryente krime shtetërore me flamur privat, për të mohuar krimet dhe mbajtur larg tyre Putin. Në rajonet Donetsk dhe Luhansk në Ukrainë, si dhe Afrikë dhe në Siri, mercenarët e “Wagner” jo vetëm morën pjesë në aksione luftarake, por edhe ruanin disa objekte naftë. Mercenarët e “Wagner” u përfshinë për herë të parë në Ukrainë në vitin 2014, kur ndihmuan separatistët në aneksimin e Krimesë.

Pas pushtimit të plotë të Ukrainës nga Rusia në shkurt 2022, aftësia e luftëtarëve të “Wagner” për të bërë përparim në betejat e ashpra në Ukrainën lindore u bë një aset i rëndësishëm ushtarak për Kremlinin. Në janar 2023, “Wagner” pretendoi se kishte marrë nën kontroll qytetin ukrainas Soledar, i parë si një nga fitoret e rralla të Moskës që nga fillimi i luftës. Efikasiteti i grupit “Wagner” dhe rëndësia e tij në rritje në fushën e betejës, “frynë” Prigozhin të nisë një fushatë të turpshme kundër zyrtarëve të lartë ushtarakë të Rusisë. Si një biznesmen i korruptuar dhe si mercenar tipik, ai mendon vetëm për paratë, e cila është e vetmja moto e mercenarit. Oreksi i është rritur në Ukrainë, ku përballë 20 000 trupave që e duartrokasën, ai ndjehet i madh, lider i rëndësishëm dhe ushtarak me përvojë dhe mban dekoratat e heroit të federatës ruse, të popullit të Donbasit dhe Luhanskut. Asnjë

lloj arsimi ushtarak apo civil nuk është shënuar në CV-ë të tij, thjesht i dekoruar si “i korruptuari i vitit” nga CNN.

Në një mesazh audio shtatë minutash, më 20 shkurt 2023, Prigozhin i dehur nga suksesi në operacionet brutale kundër popullsisë civile, akuzoi komandantët më të lartë ushtarakë të Rusisë për “tradhti” për privimin e municioneve të luftëtarëve të tij. “Unë nuk jam në gjendje ta zgjidh këtë problem me gjithë lidhjet dhe kontaktet e mia deklarohen ai në eufori e sipër. Prigozhin ka sulmuar personalisht ministrin e Mbrojtjes, Sergei Shoigu dhe gjeneralin e lartë rus Valery Gerasimov, të cilët ai mendon se mund t’i zëvendësojë. Bakhmut do të ishte marrë para Vitit të Ri 2023, nëse nuk do ekzistonte burokracinë tona ushtarake dhe shkopinj të që futen në rrota çdo ditë”, - deklaroi Prigozhin për median shtetërore ruse. Në delir nga brohoritjet alla sovjetike të mercenarëve të tij, ai bind veten se është një lider i mundshëm global. Indirekt por shumë qartë ai i kërkon Putinit një post ushtarak në ushtrinë e rregullt tashmë, pasi të tjerat i ka arritur.

Unë e quaj të dehur, pasi nuk dua ta cilësoj budalla Prigozhin, sepse Putin njihet se është një shtetar dhe e di mirë baraslargësinë që duhet të mbajë nga krimet e “Wagner”. Ky Don Kishot i shekullit të 21-të beson se me një ushtri të shiturish, pa atdhe dhe ideal mund të sfidojë një fuqi bërthamore botërore. Madje sot për Putin është një rast për të faturuar tek Prigozhin dhe ushtria e tij private, të gjitha krimet kundër njerëzimit që mund t’i ngarkojë në të ardhmen



gjykata ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, e cila aktualisht po mbledh prova dhe dëshmi në terrenin e luftës.

Putin është i vetmi autoritet që mund të kritikojë gjeneralët rusë në publik, por në këtë rast Prigozhin i duhet për t'i bërë një lloj presioni atyre. Pavarësisht veshjes ushtarake nga Prigozhin nuk ka asgjë tjetër të tillë. Marshimi me tanke dhe autoblanda drejt Moskës, ishte më e pakta, veprimi më idiot i një drejtësie të vetëshpallur ushtarak. Ai tregoi se nuk njeh, nuk di, nuk vlerëson dhe nuk analizon asnjë faktor në luftë. Pa asnjë mjet ajror dhe duke paralajmëruar një ditë para, përmes marshimit në autostrada ai mendon

se mund të marrë Kremlinin. Duket se është bërë “esëll” nga telefonata e Lukashenkos, i cili i ka treguar se çfarë e pret me siguri nëse e bën.

“Wagner” është një organizatë kriminale “brutale” transnacionale, që fitoi koncesione energjetike në Siri në këmbim të mbështetjes ushtarake. Në Sudan dhe në Republikën e Afrikës Qendrore, “Wagner” është përfshirë në biznesin e minierave për të financuar operacionet të tij. Për të shmangur sanksionet dhe për të fshehur financat e tij, “Wagner” shpesh bën pagesa në ar, diamante dhe dërgesa të naftës dhe gazit. “Financial Times” vlerëson se midis 2018 dhe 2021, të ardhurat nga

zotërimet e “Wagner” në burimet natyrore ishin afërsisht 250 milionë dollarë. Thesari ka identifikuar partnerët e biznesit që po ndihmojnë “Wagner-in” të luftojë në Ukrainë: dy firma ruse - “Terra Tech” dhe AO BARL - dhe “China’s Spacety”, e cila ofron imazhe satelitore për grupin. Një njoftim në kanalin “Telegram” të “Wagner” u ofron rekrutëve të rinj një minimum prej 240 000 rubla në muaj (2,236 £; 2,843 dollarë) - një rrogë mujore e lartë për shumicën e rusëve, veçanërisht ata në rajonet e varfra. Ai liston qendrat e thirrjes në të gjithë Rusinë, ku kryesore është në Molmino në jug të largët. Organizata e tij është tani në mes të një kryengritjeje të dukshme, pasi pretendoi kontrollin e objekteve ushtarake në dy qytete dhe kërcënoi të marshonte drejt Moskës. Prigozhin dikur ishte një aleat i ngushtë i presidentit rus Vladimir Putin, por udhëheqësi i Kremlinin tani është zotuar se do të ndëshkojë ata që janë përfshirë në “një rebelim të armatosur”. Zakonisht një figurë që ka preferuar të operojë në hije, Prigozhin dhe luftëtarët e tij u vunë në qendër të vëmendjes pas pushtimit rus të Ukrainës vitin e kaluar, me mercenarët e “Wagner” që luanin një rol kyç në betejat të shumta.

Pas pushtimit rus të Ukrainës në vitin 2022, grupi u fut në qendër të skenës. Forcat “Wagner” u përfshinë në marrjen e qyteteve ukrainase Soledar dhe Bakhmut. Ndërsa fushata e rregullt e ushtrisë ruse u bllokua nga pengesat dhe çorganizimi, luftëtarët e “Wagner” dukej se ishin të vetmit të aftë për të ofruar përparim për palën ruse. I njohur për shpërfilljen e jetës së ushtarëve të vet, taktikat brutale dhe shpesh të paligjshme të “Wagner” besohet se kanë rezultuar në një numër të madh viktimash, pasi rekrutët e rinj dërgohen në betejë me pak trajnime formale. Prigozhin ka përdorur mediat sociale për të lobuar për atë që ai dëshiron dhe shpesh e ka konsideruar veten si “kompetent dhe të pamëshirshëm” në kontrast me institucionin ushtarak të Kremlinin.

Në një video nga fillimi i majit, Prigozhin qëndronte pranë një grumbulli luftëtarësh të vdekur “Wagner” dhe shënjestroj veçanërisht ministrin

rus të mbrojtjes Sergei Shoigu dhe shefin e forcave të armatosura ruse, gjeneralin Valery Gerasimov. “Gjaku është ende i freskët”, - thotë ai, duke treguar trupat pas tij. “Ata erdhën këtu si vullnetarë dhe po vdesin që ju të mund të uleni si macet e majme në zyrtat tuaja luksoze”. Pasi u ankua për më shumë se një muaj për marrjen e mbështetjes së pamjaftueshme nga Kremli në luftën rraskapitëse për qytetin lindor të Bakhmut, ai njoftoi në maj se trupat e tij do të tërhiqeshin.

Rebelimi i “Wagnerit” filloi kur Prigozhin lëshoi një tiradë të re kundër ushtrisë ruse të premtën dhe më pas marshoi trupat e tij në qytetin rus të Rostov-on-Don. Duke parë një përshkallëzim të papritur të tensioneve të brendshme që kanë filluar për muaj të tërë, Putin i quajti veprimet e Wagner-it “tradhti”. Është një thikë në shpinë të vendit dhe popullit tonë”, - tha presidenti në një fjalim drejtuar kombit të shtunën. Prigozhin u përgjigj në Telegram, duke thënë se Putin ishte “gabim” dhe ne jemi patriotë të Atdeut tonë, kemi luftuar dhe po luftojmë.

“Wagner” pushtoi Rostov-on-Don në jug, më pas përparoi drejt Moskës. Shumë analistë menduan se marrëveshja e dukshme për të mos e ndjekur penalisht atë tregoi dobësi nga Presidenti Vladimir Putin, i cili kishte denoncuar “tradhtinë” e “Wagner” në një fjalim televiziv.

Në vend të kësaj, Prigozhin iu ofrua mërgim në Bjellorusi ose më qartë një “burg i cilësisë së lartë ruse”, pasi dihen marrëdhëniet dhe pozicioni i Minskut përballë Putin. Në një mesazh audio 11-minutësh në “Telegram”, më 27 qershor, Prigozhin tha se ai nuk kishte në shënjestër presidentin Putin dhe nuk kishte dëshirë të përmbyste regjimin, kur deklaroi se trupat e tij do të marshonin drejt Moskës, më 24 qershor. Ai tha se “Wagner” kishte kërkuar “të bënte përgjegjës ata njerëz që bënë një numër të madh gabimesh gjatë operacionit special ushtarak, me veprimet e tyre joprofesionale.

Këtu duket shumë qartë, se efekti i “voddës” ka kaluar, dhe ai përpiket të thotë gjëra që askush nuk i merr seriozisht. Kritikon profesionistët ushtarakë një oligark i pasuruar me korrupsion dhe pa asnjë lloj formimi në fushën e sigurisë. Nga ana tjetër i puth dorën Putinit nga pamundësia për ta kafshuar. Prigozhin tha se grupi marshoi për të ndaluar shpërbërjen e “Wagner-it” të pa lajmëruar, më 1 korrik 2023, dhe përfshirjen në këtë projekt të Ministrisë ruse të Mbrojtjes dhe se ai i urdhëroi trupat e tij të ktheheshin “për të shmangur derdhjen e gjakut të ushtarëve rusë”. E vërteta është krejt ndryshe, pasi ishte i qartë fati i mercenarëve të tij përballë historisë dhe mureve të Moskës. Ai thjesht bëri autokritikë.

Ishte hera e parë që Prigozhin fliste që kur ra dakord për të ndërprerë përpjekjen e tij për kryengritje të shtunën vonë. “Wagner” u drejtua në veri drejt Moskës përmes qytetit të Voronezh, duke shkaktuar një gjendje të jashtëzakonshme në kryeqytet dhe rreth tij.

Kremlini është zotuar të inkorporojë “Wagner-in” në forcat e armatosura të rregullta ruse.

Por “Wagner” ishte ende hapur, duke rekrutuar në radhët e veta të hënën për shërbimin në “operacionin special ushtarak” të Rusisë në Ukrainë.

Mes konfuzionit rreth statusit të “Wagner”, ministri i Jashtëm Sergei Lavrov tha më 26 qershor se grupi do të vazhdojë rolin e tij ushtarak në Mali dhe Republikën e Afrikës Qendrore (CAR). Luftëtarët e “Wagner” kanë reputacion për brutalitetin në Afrikë dhe kanë luajtur një rol kyç në Siri, duke mbështetur forcat e presidentit Bashar al-Assad. Në Ukrainë, muaj të tërë luftimesh të ashpra në qytetin e shkatërruar të Bakhmut besohet se kanë kushtuar mijëra jetë njerëzish “Wagner”.

Sido që të shkojë statusi i “Wagner”, ka të ngjarë që Prigozhin të akuzohet për krime lufte nga Rusia, për operacionet në Ukrainë, duke i veshur atij çdo shkelje të ligjit ndërkombëtar. Ndërsa mundësia tjetër pritët të jetë vdekja e papritur e tij nga helmimi, me një shishe pije në dorë, si shumë sfidues të Putinit në 23 vitet e pushtetit të tij.



Inteligjenca artificiale është gati të eliminojë miliona vende pune aktuale dhe të krijojë miliona të reja.

Ka dy anë të kësaj medaljeje: Robotët dhe AI-ja do të heqin disa punë nga njerëzit, por do të krijojnë gjithashtu vende të reja pune. Që nga viti 2000, robotët dhe sistemet e automatizimit kanë hequr ngadalë shumë punë në prodhim – 1.7 milionë prej tyre. Nga ana tjetër, parashikohet që AI-ja do të krijojë 97 milionë vende të reja pune deri në vitin 2025.

A do të zëvendësojë punët Inteligjenca Artificiale?

AI-ja po e bën tashmë dhe do të vazhdojë të zëvendësojë disa vende pune. Punëtorët në industri që variojnë nga kujdesi shëndetësor në sektorët e bujqësisë dhe industriale mund të presin të gjithë të shohin ndërprerje në punësimin për shkak të AI-së. Por kërkesa për punëtorë, veçanërisht në robotikë dhe inxhinieri softuerike, pritet të rritet falë AI-së.

Disa njerëz nuk e shohin atë në të dyja anët. Për shembull, Sean Chou, ish-CEO i startup-it të inteligjencës artificiale “Catalytic”, mendon se robotët janë budallenj dhe ai nuk është i vetëm në vlerësimin e tij të singertë. “Gjithçka që duhet të bëni është të shkruani ‘Roboti i YouTube dështon’”, - tha Chou.

